

Reagim

Gjatë ditëve të fundit, World Vision në Kosovë ka ndjekur me shqetësim raportimin në media për episodin e dhunës dhe abuzimit seksual ndaj një fëmije. Si një organizatë e cila punon prej vitesh për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, ne dënojmë me forcë akte të tilla dhune të cilat çënojnë thelbësisht mirëqenien e fëmijës.

World Vision beson se çdo fëmijë duhet ta jetojë jetën në plotësinë e vet, të jetë i mbrojtur nga çdo lloj forme dhune dhe abuzimi. Mbrojtja e fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës është shkelje e hapur e Ligjit 06/L-84 për Mbrojtjen e Fëmijës në Republikës e Kosovës, i cili është në fuqi që prej vitit 2019. Ky ligj përcakton shprehimisht në Nenet 48 të tij se fëmija duhet të mbrohet nga të gjitha format e dhunës, përfshirë këtu edhe abuzimin seksual. Ndërsa në Nenin 52 të këtij ligji përcaktohet qartë mbrojtja e fëmijës nga pornografia si vijon: Ndalohet çfarëdo paraqitje, në çfarëdo mënyre, e një fëmije të përfshirë në aktivitete eksplicite seksuale reale ose të simuluar apo çfarëdo paraqitje e pjesëve intime të trupit të një fëmije... dhe se ngarkohen autoritetet përkatëse për të mbyllur hapësirat e përdorura për prodhimin e pornografisë së fëmijës.

Ka qenë tronditëse për ne të mësonim faktin se palët e përfshira në këtë ngjarje janë të gjithë fëmijë. Por, ndërsa World Vision qëndron në krah të të mbijetuarve të dhunës dhe mbështet çdo veprim që siguron mirëqenien e tyre, si edhe ofrimin e shërbimeve cilësore e të shpejta, ne po ashtu bëjmë thirrje për trajtimin me dinjitet edhe të fëmijëve të tjerë të përfshirë në këtë ngjarje. World Vision do të vazhdojë të ngrejë zërin dhe të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve të posaçme që synojnë parandalimin dhe mospërsëritjen e çdolloj forme dhune ndaj fëmijëve. Si një organizatë që punon për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve, kërkojmë zgjidhjen konkrete të rastit në fjalë nga organet kompetente.

Duhet një botë e tërë për t'i dhënë fund dhunës ndaj fëmijëve, prandaj ne besojmë se është përgjegjësi e të gjithëve ne: e anëtarëve të shoqërisë, e familjes, e institucioneve arsimore, e institucioneve të tjera në nivel qendror e komunal, e shoqërisë civile, dhe e kujtdo tjetër që të sigurojë mbrojtjen e fëmijëve. Po ashtu, është përgjegjësi e të gjithëve ne që t'iu mësojmë dhe përcjellim fëmijëve vlerat pozitive të dashurisë, respektit, kujdesit për veten dhe për të tjerët, ndërkohë që iu mësojmë të bëjnë qartazi dallimin mes këtyre më sipër dhe veprimeve që lëndojnë të tjerët dhe janë veprime të papranueshëm. Në këtë këndvështrim, World Vision i bën thirrje të gjitha institucioneve, medias, dhe shoqërisë në tërësi që të përdorin fuqinë e tyre në rritjen e ndërgjegjësimit për mospërsëritjen e akteve të dhunës ndaj fëmijëve. Përkundrazi, ne dëshirojmë të nxisim promovimin e modeleve pozitive të fëmijëve dhe të të rinjve të cilët frymëzojnë bashkëmoshatarët e tyre, mbrojnë veten dhe të tjerët nga çdo formë dhune, si dhe raportojnë për raste të dhunës ndaj fëmijëve.